

Në bazë të nenit 8 pika 1 e Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, si dhe duke u bazuar në nenin 5 dhe 6 pika 5 e Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A me date 21/04/2022 shpall këtë:

## KONKURSI PUBLIK PERSERTITJE

Shpallim plotësimin e vendit të lirë të punës për pozitën

Titulli i punës: **Një inxhinier me Bachelor i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik në Njësinë Operative Lugbunar ne Gjakovë**

Numri i referencës: 257

Vendi: Gjakovë

Kohëzgjatja: Puna provuese 6(gjashtë) muaj me mundësi vazhdimi në pajtim me Ligjin e Punës

**Detyrat dhe përgjegjësitë për pozitën e inxhinierit ne Njësinë Operative Lugbunar në Gjakovë**

- Ndhmon në përpilimin e planeve aftagjate dhe vjetore të operimit, mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të sistemit të ujitjes dhe kullimit;
- Ndhmon në përpilimin e projekteve, raporteve dhe informatave në lidhje me operimin, mirëmbajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit;
- Reagon dhe ndihmon në zgjidhjen e vështirësive, kërkesave dhe ankesave të qytetarëve (fermerëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve) duke punuar në bashkëpunim dhe në lidhshmëri me Njësitë tjera punuese në kuadër të Kompanisë;
- Kujdeset dhe mban evidencën për dinamikën e lagështisë së tokës. Ndhmon edhe
- njësitë tjera nëse paraqitet nevoja me punëtorë dhe në mënyrë profesionale;
- Ndhmon në mbajtjen e evidencës së harxhimit të sasisë së përgjithshme të ujit si dhe për çdo nënsistem në kuadër të njësisë dhe ndihmon njësitë tjera;
- Bën paraqitjen e dëmeve për objektet e sistemit dhe përcjell të gjitha avaritë që ndodhin në sistemin e ujit ku shtrihet Njësia;
- Së bashku me Udhëheqësin e Njësisë bën vërtetimin e sipërfaqeve që ujiten për çdo muaj gjatë sezonës dhe për këtë kërkon nga tekniku i bujqësisë shënime për shfrytëzimin e ujit.

### Kualifikimi:

- Për pozitën nën një duhet ta ketë te kryer fakultetin e ndërtimtarisë-drejtimi hidroteknik.

### KUSHTET:

- Të ketë përvojë në punë dhe në detyra të ngjajshme,

- Të jenë në gjendje që ti kryejnë detyrat e punës me përgjegjshmëri.
- Te jenë në gjendje të punojnë nën presion dhe jashtë orarit të punës.
- Të kenë aftësi komunikimi, raportimi, dhe përshtatshmëri në punë ekipore.

**Procedura e Aplikimit dhe dokumentacioni i nevojshëm:**

Aplikacioni–kërkesa mund të merret në ueb faqen e kompanisë <https://kruradoniqi-dukagjini.com> dhe të bashkëngjiten dokumentet në vijim:

- CV e detajuar
- Diploma përkatëse e noterizuar, certifikatat e trajnimeve.
- Dëshmi mbi përvojën në punë.
- Certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit.
- Dëshmi të mos të jenë të dënuar dhe nën hetime.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në zarf të mbyllur në adresën zyrtare Objekti administrativ KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A që gjendet në Gjakovë rruga e UÇK-së. p.n.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjete) dite kalendarike, afati i fundit për aplikim është data 05/05/2022 deri në ora 16.00

Vërejtje Kandidatet me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe pas afatit të konkurrimit do të refuzohen. Do të kontaktohen vetëm kandidatet të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara dhe të përfshirë në listën e ngushtë.